



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ragip Begaj , Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević , Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Shkelqim Jakupi , Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL - Datë: 25.06.2018
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës Nr. 020-720
Lloji i aktit	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/97 për lejimin e ndaljes dhe parkimit përgjatë rrugës " Rilindja Kombëtare" (IBRAHIM MAZREKU) në Malishevë
I miratuar më datë: 30.04.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 20.06.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ragip Begaj , gradonačelnik opštine Mališevo Rrahim Morina , predsedavajući Skupštine opštine Mališevo
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini
Preko:	Ivan Todosijević , ministar MALS-a, <i>20-8.F. [Signature]</i> Rozafa Ukimeraj , generalni sekretar MALS-a
Od:	Shkelqim Jakupi , rukovodilac pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS - <i>[Signature]</i> Dana: 25.06.2018. Br. 020-720
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo.
Vrsta akta:	Odluka

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.02/97 za dozvoljavanje stajanja i parkiranja niz ulice "Rilidnja Kombetare" (IBRAHIM MAZREKU) u Mališevo.

Usvojena dana: 30.04.2018. godine

Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 20.06.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

MINISTRI E ADMINISTRIMIT TË PUSHTIET LOKAL
OPŠTINA MALISHEVA
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Opština Malisheva
Kuvendi i Komunës në Malisheve
20.06.2017

№	Emri i Autorit	№ i Lejes	Shtypja	Çmimi
1	U-010-720			

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/17
Datë: 04.05.2018

Mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 pika d, nenin 17 pika f, nenin 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", mbështetur në nenin 7, 9 paragrafi 1, nenin 13 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.32/5 Shtator 2016", nenin 10 dhe 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.04.2018 merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJTIMIN E NDALJES DHE PARKIMIT PËRGGJATË RRUGËS "RILINDJA KOMBËTARE"
(IBRAHIM MAZREKU) NË MALISHEVË

1. Miratohet në kërkesa nr.02/97 e datës:11.04.2018 e parashtruar nga Shefi i grupit të anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Malishevë, për rikthimin e të drejtës së parkimit të makinave përgjatë rrugës "Rilindja Kombëtare" (Ibrahim Mazreku) në Malishevë, nga rrethrotullimi deri te rruga "Hamdi Berisha".
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi nga ora 07.00 e mëngjesit deri në orën 19.00 të mërkurës lejohet vetëm ndalja e veturave në kohëzgjatje prej 15 minutave, kurse prej orës 19.00 deri në ora 07.00 e mëngjesit lejohet parkimi pa ndalesë i veturave.
3. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike të bëjë vendosjen e tabelave dhe shënjëzimin e tyre përgjatë kësaj rruge konform rregullave të trafikut rrugor.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes organeve kompetente.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës. dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi iu dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorisë për Shërbime Publike
MAPL-së.

Kryetari i Kuvendit
Rahim Morina